



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Himarë, më 15.02.2021

Lënda : Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion i datës 12.02.2021.

Në vijim të kërkesës suaj dërguar në e-mail-in zyrtarë të Bashkisë Himarë , protokolluar në institucionin tonë me nr.574 prot të dates 12.02.2021, lidhur me informacionin e detajuar për marrëveshjen mes Bashkisë Himarë dhe Ministrisë së Drejtësisë për ‘Sigurimin e kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja personale për të miturit në konflikt me ligjin’ ju bëjmë me dije se :

Marrëveshja është nënshkruar mes Ministrisë së Drejtësisë, e protokolluar me nr. 4161/1 prot, Tiranë më 10.07.2020 dhe Bashkisë Himarë, e protokolluar me nr.2092/1 prot, Himarë më 10.07.2020.

Në përgjigje të pyetjes mbi institucionin e përzgjedhur dhe stafin e angazhuar për ofrimin e programeve psiko-sociale ju sqarojmë se Bashkia Himarë ka marrëveshje me qendrën psiko-sociale ‘Vatra’, e cila ofron shërbime psiko-sociale dhe strehëza të përkohshme.

Lidhur me pyetjen e numrit të rasteve të trajtuara me të miturit nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes, ju bëjmë me dije se s’është trajtuar asnjë rast nga momenti i nënshkrimit deri më sot.

Për pyetjen nëse familjarët e fëmijëve kanë marrë shërbime nga programet që institucioni ynë ofron, ju sqarojmë se Bashkia Himarë nuk ka një program për ofrimin e programeve konkrete për familjarët e të miturve që kanë konflikt me ligjin.

Për pyetjen për përdorimin e protokolleve të përdorura për zbatimin e kësaj marrëveshjeje ju bëjmë me dije se ne përdorim protokollin e punës së punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve për të trajtuar rastet.

Për sa i përket pyetjes për përmbajtjen e programeve që përdoren për rehabilitimin e të miturve që kanë konflikt me ligjin, ju sqarojmë se institucioni ynë aplikon programe këshillimi dhe edukimi , ndërsa programet e drejtësisë restauruese dhe programe të tjera që lidhen me rehabilitimin i përcakton prokurori se cili institucion duhet t’i ndjekë sipas vendimit të masës së shmangies.

Për pyetjen për trajnimin e punonjësve për trajtimin e të miturve me masën e shmangies ju bëjmë me dije se nuk është bërë asnjë trajnim nga institucionet përgjegjëse.

Mendimi ynë për funksionimin e kësaj marrëveshjeje është pozitiv, pasi përfshin të gjitha pikat ku duhet të përqëndrohet trajtimi i të miturve që kanë konflikt me ligjin për zbatimin e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale.

Për pyetjen për nivelin e bashkëpunimit me 'Drejtorin territoriale të shërbimit të provës Vlorë' ju bëjmë me dije se institucioni ynë ka një bashkëpunim të ngushtë dhe korrekt.

Për sa i përket pyetjes së fundit për sugjerimet tona mbi funksionimin e mirë të kësaj marrëveshjeje, ne sugjerojmë se duhet më shumë bashkëpunim mes Komisarariatit të Policisë dhe pushtetit vendor për të patur një trajtim sa më të mirë me të miturit që kanë konflikt me ligjin, si dhe trajnim të stafit të tyre për t'u njohur me ndryshimet e reja në procedurën me të miturit, sepse shumë prej punjësve nuk e marrin parasysh që rasti është i mitur dhe ai trajtohet si gjithë procedurat e tjera.

Ju faleminderit!

KRYETARI

Jorgo Goro